

# STATUT

## Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Francë- Shqipëri

*Përditësuar më 30 Prill 2021*

### KAPITULLI I AKTIVITETET

#### ❖ NENI 1

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Francë - Shqipëri (më poshtë referuar si CCIFA) është një shoqatë jofitimprurëse me seli në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla Nr.1, Kati 7, Zyra Nr. 20, Tiranë, Republika e Shqipërisë.

CCIFA ka për qëllim të favorizojë zhvillimin e marrëdhënieve tregtare ndërmjet Francës dhe Shqipërisë.

#### **Për këtë ajo u propozon anëtarëve të saj:**

- a) T'i asistojë në krijimin e një rrjeti kontaktesh ndërmjet shoqërive shqiptare dhe atyre franceze dhe t'u japë atyre këshilla dhe ndihma të tjera me qëllim të arritjes së marrëveshjeve ndërmjet tyre.
- b) Të shërbejë si ndërmjetësuese për ndërmarrjet, për të dhënë këshillim dhe asistencë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve, me të cilat ato do të përballen.
- c) Të orientojë, veçanërisht eksportuesit francezë në tregun shqiptar, duke i ndihmuar ata në vendosjen e tyre në tregun shqiptar.
- d) T'i udhëzojë dhe t'i udhëheqë gjatë udhëtimit të tyre për biznes në Shqipëri.
- e) Të ruajë marrëdhëniet me autoritetet publike, grupet tregtare dhe financiare, CCIFA-të e tregtisë, sindikatat, etj., me qëllim që të monitorojë kuadrin ligjor të marrëdhënieve ekonomike të të dy vendeve, në mënyrë të favorshme për anëtarët.
- f) Të organizojë të gjitha llojet e eventeve (ekspozita, konferenca, seminare, dreka pune, misione, pritje, operacione të marrëdhënieve me publikun) që kanë për qëllim forcimin e marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve franko-shqiptare të biznesit.
- g) Dhe çdo aktivitet tjetër, me veprim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në zhvillimin e marrëdhënieve Francë-Shqipëri.

#### ❖ NENI 2

CCIFA do të bashkëpunojë drejtpërdrejt me administratën, organizatat tregtare dhe industriale, si dhe me Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë dhe institucione të tjera të ngjashme në Shqipëri dhe jashtë saj. CCIFA mund, nëse është e nevojshme, t'u bëjë thirrje kontraktorëve dhe konsulentëve të jashtëm.

CCIFA informon vazhdimisht anëtarët e veprimtarive të saj, qoftë nëpërmjet komunikimeve të veçanta ose përmes botimeve periodike.

f

### ❖ NENI 3

CCIFA u jep përparësi anëtarëve e saj të përfitojnë nga ofertat dhe kërkesat që i vijnë. CCIFA gjithashtu mund të veprojë si një ofrues shërbimi kundrejt anëtarëve të saj dhe / ose palëve të treta.

## KAPITULLI II PËRBËRJA

### ❖ NENI 4

**CCIFA përbëhet nga:**

- 1) Anëtarët e "Nderit"
- 2) Anëtarët "Strategjikë"
- 3) Anëtarët "Plus"
- 4) Anëtarët "Pjesëmarrës"

**Nivelet e kontributeve vjetore janë si më poshtë:**

- 1) Anëtarët "Strategjikë" - 1500 Euro
- 2) Anëtarët "Plus" - 800 Euro
- 3) Anëtarët "Pjesëmarrës" - 300 Euro

Anëtarët e "Nderit", nuk janë të detyruar të paguanë kontribut.

### ❖ NENI 5

**Anëtarët e "Nderit" të CCIFA janë:**

- Ambasadori i Republikës Franceze në Shqipëri, në cilësinë e Presidentit të Nderit, gjatë mandatit të tij.
- Presidentët e CCIFA, të cilët kanë ushtruar me sukses tre mandate të njëpasnjëshme,
- Shefi i Shërbimit Ekonomik Rajonal të Zonës së Danubit Ballkanik, gjatë ushtrimit të mandatit të tij.

### ❖ NENI 6

Anëtarët e "Nderit" ftohen në Asamblëtë e Përgjithshme dhe në mbledhjet e Këshillit. Ata kanë të drejtë të marrin pjesë në vendime dhe të ushtrorjnë të drejtën e votës nëse dëshirojnë.

### ❖ NENI 7

✓

**Të gjithë anëtarët e CCIFA janë të detyruar që:**

- Të respektojnë këtë Statut dhe vendimet e organeve drejtuese;
- Të paguajnë shpenzimet e regjistrimit dhe kontributet vjetore;
- Të zhvillojnë aktivitetin e tyre në respektim të ligjit dhe praktikave tregtare;
- Të përmbushin detyrimet e tjera të parashikuara nga ligji.

❖ **NENI 8**

Për t'u bërë anëtar i CCIFA në Shqipëri, Ju duhet të bëni kërkesën, duke plotësuar formularin e regjistrimit dhe pas vendimit të pranimit, të paguani kontributin vjetor. Të gjitha kandidaturat janë subjekt i miratimit nga Këshilli i Administrimit.

❖ **NENI 9**

**Anëtarësimi në CCIFA përfundon:**

- a) Me dorëheqje vullnetare, dorëzuar Presidentit, në përputhje me dispozitat e nenit 12;
- b) Për të gjithë anëtarët, në rast të mos pagesës së kontributit të caktuar ndaj CCIFA, sipas neneve 11 dhe 12;
- c) Në rast të falimentimit ose likuidimit gjyqësor për personat juridikë;
- d) Në rast të përjashtimit me vendim të Këshillit të Administrimit, të marrë së paku nga katër të pestat e administratorëve të pranishëm;
- e) Sjellje të dëmshme për imazhin dhe funksionimin e duhur.

❖ **NENI 10**

Anëtarët e CCIFA të përmendur në pikën b ) të nenit 9, mund të ripranohen vetëm pas pagesës së shumave që i detyrohen CCIFA dhe duke u pajtuar me procedurën e përgjithshme të pranimit të vendosur për anëtarët e rinj.


Një anëtar që jep dorëheqjen ose është përjashtuar nga CCIFA nuk ka të drejtë për asnjë rimbursim të kontributit, dhe as të drejtë për dëmshpërblim.

**KAPITULLI III  
BURIMET**

❖ **NENI 11**

**Burimet e CCIFA përbëhen nga:**

- a) Kontributet vjetore të të gjithë anëtarëve;
- b) Subvencionet e qeverisë dhe të tjera;
- c) Të ardhurat e ndryshme nga aktivitetet dhe misionet e kryera;
- d) Donacionet sipas legjislacionit në fuqi.




❖ **NENI 12**

Të gjithë anëtarët paguajnë një kontribut vjetor. Kontributi për CCIFA duhet të paguhet jo më vonë se data 1 Mars për vitin kalendarik në vazhdim, i cili fillon më 1 Janar dhe mbyllet më 31 Dhjetor. Në raste të veçanta, mund të negociohet një kalendar pagese dhe mund të autorizohen kompensimet kontabël.

Do të konsiderohet si detyrim për anëtarët, të cilët nuk kanë njoftuar me shkrim dorëheqjen e tyre para 31 Janarit të vitit në vazhdim.

❖ **NENI 13**

Të ardhurat e tjera të CCIFA përbëhen nga tepricat që vijnë nga misione të ndryshme, siç janë hetimet e veçanta, udhëtimet në misione, informacionet e aftësisë paguese, përkthimet, njoftimet, organizimi i ngjarjeve etj.



❖ **NENI 14**

CCIFA i ka të ndaluara të gjitha veprimtaritë, që nuk janë në përputhje me ligjet në fuqi

## **KAPITULLI 1V**

### **ORGANIZIMI- KËSHILLI I ADMINISTRIMIT -KOMITETI I PËRZGJEDHJES**

❖ **NENI 15**

Menaxhimi i veprimtarive të CCIFA i është besuar Këshillit të Administrimit, pa shpërblim, i cili përbëhet nga anëtarë të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme, jo më pak se 7, por jo më shumë se 9.

❖ **NENI 16**

Kandidatët për postin e 1 (një) - Presidenti, 3 (tre) - Zëvendës Presidentëve, 5 (pese) - Administratorëve, një nga të cilët Administrator & Përgjegjës i Financës, i propozohen për votë Asamblesë së Përgjithshme.

Këta kandidatë zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme, bazuar në paraqitjen e kandidaturës së tyre për pozicionet e mësipërme.

Do të zgjidhen si anëtarë të Këshillit dhe si Zëvendës Presidentë vetëm anëtarët e CCIFA që kanë statutin e anëtarit "Strategjik", në përputhje me nenin 4 të këtij Statuti.

Për të qenë kandidat si anëtar i Këshillit, kandidati duhet të gëzojë statusin "strategjik" të CCIFA, në kuptim të nenit 4 të këtij Statuti.






Anëtarët e Këshillit të Administrimit ose të punësuarit e tyre, ortakë ose vartës, nuk mund të kenë një post ekzekutiv në Dhoma të tjera të Tregtisë në Shqipëri ose në ndonjë vend tjetër. Në kuptim të këtij neni, post ekzekutiv do të thotë, funksionin e Presidentit, Zëvendës Presidentit, Sekretarit të Përgjithshëm, dhe/ose Drejtor Ekzekutiv të këtyre Dhomave Tregtare. Ky kufizim zbatohet vetëm për pjesëmarrjen në shoqata, të cilat kanë statusin e Dhomave të Tregtisë.<sup>1</sup>

Një anëtar i CCIFA nuk mund të ketë më shumë se një përfaqësues në Këshillin e Administrimit, sikurse asnjë anëtar i Këshillit nuk mund t'i nënshtrohet një anëtari tjetër nga një marrëdhënie e varur nga paga, vartëse ose bashkëpunëtorë në të njëjtën ndërmarrje anëtare e CCIFA që merr pjesë në Këshillin e Administrimit.

#### ❖ NENI 17



Administratorët zgjidhen për dy vjet. Ata mund të rizgjidhen. Çdo administrator, i cili nuk merr pjesë në dy seanca të njëpasnjëshme të Këshillit të Administrimit, pa paraqitur një justifikim të vlefshëm do të konsiderohet se është dorëhequr.

#### ❖ NENI 18

Në rast vakance për arsye të dorëheqjes, vdekjes ose shkaqe të tjera, Këshilli i Administrimit duhet të shtojë përkohësisht një administrator të ri sipas listës së zgjedhjeve të mëparshme për të arritur numrin minimal prej 5 anëtarësh deri në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

#### ❖ NENI 19

Për çdo dy vite financiare, Asambleja e Përgjithshme zgjedh (me votim të fshehtë): Një president, tre Zëvendës Presidentë dhe pesë Anetare të Këshillit Drejtues, nga të cilët një Anëtar Këshilli është edhe & Përgjegjës i Financës. Presidenti duhet të jetë shtetas Francez ose Shqiptar, të banojë në Shqipëri dhe të ketë një emër të mirë në fushën e aktivitetit të tij. Do të zgjidhet President, anëtar që gëzon të paktën statusin "strategjik" të CCIFA (në kuptim të nenit 4 të këtij Statuti) minimumi gjatë dy viteve të njëpasnjëshme dhe pa ndërprerje që i paraprijnë drejtëpërdrejtë vitit të kandidimit të tij. Presidenti ushtron mandatin e tij për një kohëzgjatje prej dy vitesh. Në rast të dorëheqjes ose largimit për shkaqe të tjera gjatë mandatit të tij, ai zëvendësohet nga njëri prej Zëvendës Presidentëve, i zgjedhur me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të Këshillit, deri në zgjedhjet e ardhshme.

---

<sup>1</sup> Post ekzekutiv është posti i Presidentit, Zv. Presidentit, Sekretarit të Përgjithshëm dhe ose Drejtorit Ekzekutiv të Dhomave të Tregtisë.



❖ **NENI 20**

Në çdo votim, në të cilin merr pjesë Presidenti, vota e tij do të mbizotërojë në rast të një barazimi të votave.

❖ **NENI 21**

Presidenti mandatohet të përfaqësojë CCIFA kundrejt palëve të treta në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ai mund t'i delegojë në çdo kohë dhe me shkrim, një anëtar të Këshillit, të zgjedhur prej tij ose Drejtorit Ekzekutiv, funksionet e përfaqësimit të CCIFA-së në raport me palët e treta sipas legjislacionit në fuqi.

❖ **NENI 22**

Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës për hartimin e proces-verbalit të çdo seance të Këshillit dhe gjithashtu përgjegjës për hartimin e raportit vjetor për aktivitetet e CCIFA. Proces-verbale të seancave të mbledhjeve të Këshillit të Administrimit do të nënshkruhen nga Presidenti dhe nga Drejtori Ekzekutiv.

❖ **NENI 23**

Përgjegjës i Financës do të jetë, për llogari të Këshillit të Administrimit, përgjegjës për mbajtjen e kontabilitetit të CCIFA dhe do të raportojë rregullisht para Presidentit të Këshillit.

❖ **NENI 24**

Këshilli i Administrimit do të mbledhet aq shpesh sa ta kërkojë interesi, në minimum katër (4) herë në vit, në ditën, orën dhe vendin e caktuar nga Presidenti. Në rast të pamundësisë madhore ose të pengimit të Presidentit, Këshilli mbledhet me njoftim të njërit prej Zëvendës Presidentëve. Këshilli mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm në rast se katër (4) prej anëtarëve të tij janë të pranishëm.

Në rast të një motivi të jashtëzakonshëm, kur mungojnë më shumë se tre anëtarë të Këshillit, mbledhjet e Këshillit mund të zhvillohen me video-konferencë.

❖ **NENI 25**

Nëse e gjykon të nevojshme, Këshilli i Administrimit mund të ngrejë komisione ndërmjet anëtarëve të CCIFA, të cilat mund të kryejnë misione të veçanta. Këto komisione do të japin llogari për misionet e tyre rregullisht, para Këshillit.

**KAPITULLI V**

f

## **KOMISIONET**

### **❖ NENI 26**

Për të zbatuar sa më mirë kompetencat e anëtarëve, me qëllim që të sigurojnë funksionimin e mirë dhe zhvillimin e CCIFA, komisionet do të emërohen nga Këshilli i Administrimit dhe do të jenë në dispozicion të tij. Komisionet do të përbëhen në minimum nga 4 (katër) anëtarë, dhe në maksimum nga 7 (shtatë) anëtarë "Strategjikë" dhe "Plus". Kohëzgjatja e aktivitetit të komisioneve do të caktohet nga Këshilli i Administrimit. Komisionet do të jenë të detyruara të hartojnë rregulloret e funksionimit dhe të caktojnë një përfaqësues/përfaqësuese, i cili/e cila do të ngarkohet për marrëdhëniet me Këshillin e Administrimit dhe do të raportojë për punën e këtyre komisioneve.

### **❖ NENI 27**

Komisionet mund të thirren në mbledhjet e Këshillit të Administrimit të paktën dy herë në vit. Rendi i ditës i këtyre mbledhjeve do të përgatitet nga Presidenti në bashkëpunim me Drejtorin Ekzekutiv, të cilët do të marrin pjesë në diskutime.

## **KAPITULLI VI DREJTORI EKZEKUTIV**

Drejtori Ekzekutiv i CCIFA emërohet nga Presidenti për një kohëzgjatje të papërcaktuar. Ai mund të shkarkohet në çdo kohë nga Presidenti. Nën mbikqyrjen dhe kontrollin e Presidentit, Drejtori Ekzekutiv e ndihmon këtë të fundit në zbatimin praktik të aktiviteteve të CCIFA, ashtu siç janë përcaktuar në nenin 2 të këtij Statuti. Drejtori Ekzekutiv, ndër të tjera, është i ngarkuar për dërgimin e çështjeve aktuale.

### **❖ NENI 29**

Funksionimi normal i CCIFA sigurohet nga Presidenti, i ndihmuar nga Drejtori Ekzekutiv. Vetëm shpenzimet e jashtëzakonshme duhet të miratohen nga Këshilli me "Vendim nga qarkullimi", të miratuara me e-mail.

## **KAPITULLI VII ASAMBLETË E PËRGJITHSHME**

### **❖ NENI 30**

Çdo vit, në gjashtë muajt pasardhës të mbylljes së vitit financiar, mbahet Asambleja e Përgjithshme, e cila mbahet në vendin dhe ditën e caktuar nga Presidenti. Njoftimet, për



j

të qenë të vlefshme, dërgohen me rrugë elektronike në adresën e komunikuar në CCIFA, nga anëtari. Anëtari është i detyruar të lajmërojë me shkrim CCIFA për çdo ndryshim të adresës. Thirrja në Asambleshë e Përgjithshme duhet t'i adresohet të gjithë anëtarëve të CCIFA, jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë para datës së caktuar për mbledhjen.

#### ❖ NENI 31

##### **Rendi i ditës së Asamblesë së Përgjithshme përmban:**

- a) Zgjedhjen e sekretarit përgjegjës për përmblidhjen e vendimeve.
- b) Leximin e raportit vjetor të Këshillit të Administrimit.
- c) Leximin e raportit të Përgjegjës të Financës.
- d) Shqyrtimin dhe miratimin e llogarive, mbi bazën e të cilave do të jepet miratimi për Presidentin dhe Administratorët për menaxhimin e tyre gjatë vitit financiar të mbyllur.
- e) Zgjedhja e anëtarëve të këshillit të Administrimit çdo dy vjet.
- f) Emërimi i Përgjegjës të Financës çdo dy vjet.
- g) Caktimi i kontributit për CCIFA dhe pagesa për shërbimet çdo dy vjet.

Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë vetëm vendimet e përcaktuara në rendin e ditës. Përsa u përket çështjeve që nuk janë përcaktuar në rendin e ditës, Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë këto vendime, vetëm nëse të gjithë anëtarët e Shoqatës marrin pjesë ose janë të përfaqësuar.

#### ❖ NENI 32

Asambleja e Përgjithshme kryesohet nga Presidenti i CCIFA, ose nga një anëtar i Këshillit të Administrimit, i mandatuar për këtë efekt nga Presidenti.

#### ❖ NENI 33

Me qëllim që Asambleja e Përgjithshme të vendosë në mënyrë të vlefshme, 50%+1 e anëtarëve të CCIFA duhet të jenë të pranishëm ose të jenë të përfaqësuar. Anëtarët që nuk janë të pranishëm mund t'i japin kompetencë njërit prej anëtarëve të pranishëm, por një anëtar nuk mund të jetë mbajtës i më shumë se pesë prokurave të anëtarëve që nuk janë të pranishëm.

#### ❖ NENI 34

Në rastin kur kuorumi i përcaktuar në nenin e mësipërm, nuk arrihet, do të thirret një tjetër Asamble e Përgjithshme, në një afat kohor maksimal prej pesëmbëdhjetë ditësh dhe do të shqyrtojë në mënyrë të vlefshme, pavarësisht nga numri i anëtarëve të pranishëm ose të përfaqësuar. Çdo anëtar i pranishëm ose i përfaqësuar ka të drejtën e një vote.

#### ❖ NENI 35

f

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme merren me shumicën e thjeshtë të votave me përjashtim të atyre që lidhen me ndryshimin e statuteve, likuidimin e çështjeve të CCIFA-s, blerjen ose tjetërsimin e pronave për të cilat kërkohet një shumicë prej dy të tretash të anëtarëve të pranishëm ose të përfaqësuar.

❖ **NENI 36**

Nëse është e nevojshme, Këshilli i Administrimit mund të thërrasë një Asamble të Përgjithshme të Jashtëzakonshme gjatë vitit financiar, por duke përcaktuar arsyen e mbledhjes së saj. Ajo mund të zhvillohet me iniciativën e Këshillit ose me kërkesë me shkrim të 50% të anëtarëve të CCIFA. Thirja për një Asamble të Përgjithshme të Jashtëzakonshme duhet të shënohet në rendin e ditës. Nuk mund të vendoset për një çështje që nuk figuron në rendin e ditës.

❖ **NENI 37**

Përgjegjësit i Financës të CCIFA është i ngarkuar të ndjekë buxhetin vjetor dhe të shqyrtojë kontabilitetin e shpenzimeve me buxhetin. Ai shqyrton raportin financiar vjetor dhe bilancin. Përgjegjësit i Financës zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme

**KAPITULLI VIII**  
**NDRYSHIMI I STATUTIT**

❖ **NENI 38**

Çdo propozim në lidhje me ndryshimin e Statutit duhet t'i adresohet me shkrim Këshillit të Administrimit, i cili do ta paraqesë për vendim në Asamblenë e Përgjithshme pasardhëse ose të jashtëzakonshme, që të votohet me kuorumin e duhur.

**KAPITULLI IX**  
**SHPËRNDARJA E CCIFA**

❖ **NENI 39**

Shpërndarja e CCIFA mund të shpallet në vijim të një vendimi të marrë nga Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme e mbledhur posaçërisht, dhe nëse votohet nga një shumicë që merr të paktën katër të pestat e votave të anëtarëve të pranishëm ose të përfaqësuar.

❖ **NENI 40**

Në rast shpërndarje, Këshilli i Administrimit do të likujdojë asetet e CCIFA: aktivet e disponueshme pas pagimit të të gjitha borxheve, do të ndahen, sipas vendimit të fundit të Asamblesë së Përgjithshme, për qëllime dhe për institucione që lidhen me objektin e CCIFA.


CCIFA do të përdorë gjatë procesit të likuidimit, emërtimin me shënimin "në proces likuidimi". Likuidimi i CCIFA bëhet nga një ose shumë likuidues të caktuar nga Asambleja e Përgjithshme.

Tiranë më 23.04.2014

**Autoriteti nënshtetëror për të gjithë anëtarët**  
(lexova dhe miratova)

**Presidenti i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë France-Albanie**

M. Julien Roche



CCI France - Shqipëri  
Nipt L 12428451 F  
CCI France - Albanie